



## TË JESH ANËTAR

Duke zgjedhur të qënit anëtar i Arci-t ke të drejtën të hysh në të gjithë rrethet e qytetit tënd. Bëhesh kështu protagonist aktiv i shoqatës; me të drejtat e detyrimit e duhura; mund të përdorësh shërbimet e të marrësh pjesë në aktivitetet e ndryshme, por mund edhe të impenjohesh për të dhënë ide dhe energjitë e nevojshme për krijimin e realizimin e tyre.

**Të qënit anëtarë do të thotë:**

- të njohësh statutin e rrethit përkatës, ta aprovosh e ta respektosh
- të marrësh pjesë aktive në jetën e rrethit
- të ushtrosh të drejtën-detyrimin tënd vendimi në asambletë e rrethit
- të marrësh pjesë në diskutimin dhe aprovimin e buxhetit vjetor, në zgjedhjen e organizmave drejtuese të rrethit dhe, nëse e shikon të nevojshme, të kandidohesh
- të impenjohesh për afirmimin e vlerave dhe dinjitetit të personave, duke mbikaluar mbi çdo lloj diference gjinije, feje, orientimi seksual e vendardheje, kulturën e të drejtave, praktikën e tolerancës, të paqes, të bashkëpunimit dhe solidaritetit midis qytetarëve
- të merresh me problemet e territorit, duke dhënë ndihmën tënde në mbështetje të qytetarëve më të dobët, për zhvillimin kulturor e civil të komunitetit
- E në fund kujto që loja, gëzimi dhe lumturia janë të ardhura të të gjithëve që çdonjëri ka të drejtën të ruaj

## TË NDËRTOJMË NJË RRETH

" Jemi një grup muzikantësh që duam të luajmë e të krijojmë muzikë, ftojme miq të rinj për të dë-gjuar muzikë, por nuk dimë ku të shkojmë . "

" Kemi dëshirë të gatujmë gjellët e recetat e vëndit tonë, të dëgjojmë muzikën tonë, të shikojmë filmat tanë, me pjesmarrjen e banuesve të lagjes. Po si i bëhet për të patur një vënd ku të takohemi?..."

" Unë dhe shokët e mi duam të bëjmë diçka konkrete për të provuar të ndryshojmë botën duke u impenjuar në plan të parë ...si mund t'ia dalim?"

**Përgjigja është e thjeshtë :** nëse ke një interes, një pasion, dëshirë e iniciativë krijo një shoqatë e bëhesh një rreth Arci.

**Krijimi i një shoqate u jep ideve tuaja këmbë të forta për të ecur. Mund të jetë një eksperiencë e madhe jete, ndërton lidhje, është një**

**moment formues i rëndësishëm edhe nga ana e punës.**

**Të marrësh pjesë në Arci do të thotë të hysh në një ndër rrjetet më të mëdhaja të shoqatave kulturore e solidale të vëndit tonë .**

**Po çfarë është një rreth?**

Është një shoqatë që nuk ka qëllime fitimi midis njerëzish që duan të promovojnë së bashku një aktivitet kulturor, zbavitës, e solidar.

**E si funksionon?**

- Akti themelues e akti i lindjes së shoqatës.
- Statuti është një grup rregullash që rregullon jetën e rrethit, që vlejnë për të gjithë anëtarët.
- Tesera të lejon të marrësh pjesë në iniciativat, aktivitetet e jetën e rrethit e shoqatës përkatë- -se.
- Kuvëndi është i përbërë prej anëtarëve të rrethit, vendos mbi programin vjetor, voton mbi buxhetin, voton këshillin drejtues.
- Këshilli drejtues përgatit e zbaton programin, zgjedh presidentin, zbaton mandatin projektues të kuvendit.

**Kur nuk është i mundur të hapet një rreth?**

Një rreth nuk është as një dyqan as një lokal, por lind prej iniciativës së qytetarëve që, pa qëllim fitimi, mbliidhen së bashku për të zhvilluar një interes të përbashkët, nuk ekzistojnë "pronarë" apo "anëtarë themelues" (që kanë të drejta të veçanta).

Është e mundur në të kundërt nëpërmjet mënyrave të lejuara nga ligji, të punosh në rreth e të kesh të ardhura personale në mënyrë të ligjshme.

Nëse krijon një shoqatë e bëhesh anëtar i Arci-t, do të gjesh mbështetje, konsulencë, shë- -rbime, këshilla:

- konsulencë (ligjore, ekonomike, shoqërore) mbi ligjet në fuqi
- asistencë ligjore e shërbime sigurimi
- konventa tregëtare për shpenzimet
- mbështetje mbi projektimin e aktiviteteve kulturore, të promovimit shoqëror e bashkëpunimit ndërkombëtar

**Pentru informatii:**